



Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi i Komunës Rahovec

Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu

-III-

Nr. i prot.
Br. prot.

304

Më
Dt.

23.09.2024

RAHOVEC - ORAHOVAC

**PROCESVERBAL I
KONSULTIMIT PUBLIK
PËR DRAFT PLANIN E
VEPRIMIT KUNDËR
DHUNËS NË BAZA
GJINORE DHUNËS NË
FAMILJE DHE DHUNËS
NDAJ GRAVE 2024-2026**

INFORMATË RRETH NJOFTIMIT

Komuna e Rahovecit, për përgatitjen e Draft-Planit Lokal të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore 2024-2026, duke u bazuar në Ligjin numër 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës së Rahovecit Nr.1005, i datës 29.3.2017 dhe Nenit 6, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018, për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, bën njoftimin për:

KONSULTIM PUBLIK

Me 15.8.2024 është publikuar njoftimi për mbajtjen e Konsultimit për Draft Planit Lokal të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore 2024-2026. Njoftimi është publikuar në webfaqen zyrtare të Komunës, facebookun e komunës dhe Platformën e Konsultimeve Publike.

1. Publikimi në webfaqe: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2024/08/Njoftim-per-konsultim-publik-per-Projektplanin-Lokal-kunder-dhunes-ne-familje-dhe-dhunes-ne-baza-gjinore.pdf>
2. Publikimi facebook: <https://www.facebook.com/share/p/tjZrgKrWJbH74mDF/>
3. Publikimi në Platformën e Konsultimeve Publike: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2024/08/Njoftim-per-konsultim-publik-per-Projektplanin-Lokal-kunder-dhunes-ne-familje-dhe-dhunes-ne-baza-gjinore.pdf>

KONSULTIMI PUBLIK

Më datë: **29.8.2024** mbahet konsultimi publik në sallën e Kuvendit Komunal. Të pranishëm kanë qenë zyrtarë komunal, qytetarë, dëshmi janë listat e nënshkrimeve.

Lajmin për mbajtjen e konsultimit mund të gjeni të publikuar në vegëzën:

<https://www.facebook.com/sliare/p/JWNkXDhKSUaxtjpi/>

Konsultimi publik filloi në orën 10:00.

Konsultimin e shpalli të hapur, **Alban Gashii**, zyrtar për **Barazi Gjinore**, njëhërit koordinatori i mekanizmit komunal. Falenderoi anëtarët e mekanizmit dhe qytetarët për pjesëmarrje.

Ky dokument është në konsultim publik prej **15.8.2024** deri me **16.9.2024**, për prezantim më të detajuar të draft dokumentit do ta bëjë Alban Gashi.

Alban Gashi ka bërë prezantimin e planit. Fillimisht ka falënderuar OSBE për bashkëpunimin e mirëfilltë. Në këtë dokument kanë punuar anëtarë e grupit punues.

Sot jemi duke e mbajtur Konsultimin publik me qytetarë për përgatitjen e Projekt planit lokal të veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjinore 2024-2026, i cili Plan është i obliguar sipas Ligjit NR.08/L-185 – Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjinore.

Hartimi i Planit Lokal të Veprimit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjinore është përpjekje e përbashkët e grupit punues për hartimin e Planit të Veprimit, Mekanizmit koordinues lokal kundër dhunës në familje në Rahovec nën koordinimin e Zyrës së Kryetarit me përkrahjen e misionit të OSBE në Kosovë dhe një spektri të gjërë të partnerëve.

Në mbledhjen e mbajtur me anëtarët e mekanizmit me datë 24.7.2024, është prezantuar Draft plani i veprimit nga OSBE ku gjatë prezantimit anëtarët e këtij mekanizmi kanë dhënë kontribut me komentet dhe sugjerimet shtesë për këtë plan.

Ky Plan është votuar një zëri nga të gjithë anëtarët e mekanizmit komunal kundër dhunës në familje, dhunës ndaj grave dhe dhunës në baza gjinore.

Afrim Dina: Përshëndetje të gjithëve, ne i kemi mbajtur disa takime për planin lokal të veprimit dhe në takimin e fundit që kemi pas i kemi dhënë sqarimet tona, ky dokument është i hapur deri me 15 shtator për të gjithë qytetarët që kanë ndonjë ide apo propozim mund të inkorporohen në këtë draft plan, dhe pas kalimit të afateve ligjore duhet të përgaditet dhe të shkohet në kuvend.

Habihe Haxhimustafa: Kisha dasht që ky drat-plan pasi që ka afat dy javor për konsulta, edhe pse e kemi në web faqen e komunës por duhet ta alarmojmë tek kolegët, tek shkollat që t'i japim pak rëndesi më shumë që nëse ka komente ti ndryshojmë para aprovimit në kuvend, këtë punë mund ta bejnë pjesëmarrësit që jemi në këtë takim, gjithashtu anëtarët e mekanizmit, besoj që do të jetë me e arsyeshme nëse ka vërejtje, sepse ne kemi mendu kur është formu plani i veprimit kundër dhunës në familje që mos të na jetë vetëm në letër por të implementohet, besoj që kështu do të jetë deri në fund edhe presim bashkëpunim më të madh me juve.

Faleminderit për pjesëmarrjen tuaj.

Konsultimi publik përfundoi në orën: 10:45.

FOTOGRAFITË DHE LISTA E NËNSHKRIMEVE



Zyra për Barazi Gjinore

Alushi